



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr III PP Prot

Gjirokastrë më 10 : 12 : 2024

Lënda: Procesverbal i mbledhjes së dates 05.12.2024

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së dates 05.10 .2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot në 05.10 .2024 në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastrë. Mbledhja po zhvillohet te mediateka pranë Universitetit “Eqrem Çabej”. Mbledhja fillon në orën 12:05 Marrin pjesë në mbledhje 21 anëtarë. Mungojnë në mbledhje: Çabeli, Feruni, Mahmutaj, Aliko, Cacaj, Kocollari, Novi, Qeli, Kristidhi, Kondi.

Znj .Rova është online

Hapet mbledhja nga Znj.Isaraj.Është kuorumi për fillimin e mbledhjes.

Znj. Isaraj paraqet rendin e ditës.

1.Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 31.10.2024 dhe 15.12.2024.

2.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01-30.11. 2024”.

3.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01-30.11 2024”.

4.P/Vendim “Për miratimin e Paketës Fiskale 2025”.

5.P/Vendim “Për miratimin e Planit Vjetor, Planit të Konsultimeve, dhe Buxhetit të Këshillit Bashkiak për vitin 2025”.

5.P/Vendim “Për miratimin e Strategjisë së Zvogëlimit të Riskut nga fatkeqësitë në Bashkinë Gjirokastrë për periudhën 2024-2030”.

6.P/Vendim “Për miratimin e identifikimit të zonave me risk në territorin e Bashkisë Gjirokastrë për periudhën 2024-2030”.

7.Të ndryshme.

Znj Isaraj lexon dhe pareqet para këshillit 1 pikë shtesë të propozuar nga ekzekutivi.P/Vendim “ Për miratimin e amendimit të marrëveshjes midis Bashkisë Gjirokastër dhe Federatës Shqiptare Të Futbollit”.

Miratohet me 19 vota pro rendi I ditës së mbledhjes me një pikë shtesë.

Hidhet në vote dhe miratohet me 21 vota pro procesverbali I mbledhjes së dates 02.11.2024 dhe 15.11.2024

Znj. Isarajparaqet pikat2 dhe 3 të rendit të ditës .

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01-30.11. 2024”.

3.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01-30. 11. 2024”, të cilat miratohen me 21 vota pro.

Znj. Isaraj:Kalohet te pika 4 e rendit të ditës e cila ka kaluar në Komisionin e Ekonomisë dhe janë mbledhur edhe kryetarët e Komisioneve të Përhershme ku u diskutua për Planin Vjetor të Këshillit, Planin e Konsultimeve dhe Buxhetin Vjetor të Këshillit .

Hidhet në votë dhe miratohet me 21 vota pro P/Vendim “Për miratimin e Planit Vjetor, Planit të Konsultimeve, dhe Buxhetit të Këshillit Bashkiak për vitin 2025.

Znj. Isaraj: Kalojmë te pikat 6 dhe 7 të rendit të ditës.

P/Vendim “Për miratimin e Strategjisë së Zvogëlimit të Riskut nga fatkeqësitë në Bashkinë Gjirokastër për periudhën 2024-2030”.

P/Vendim “Për miratimin e identifikimit të zonave me risk në territorin e Bashkisë Gjirokastër për periudhën 2024-2030”.

Z. Llogo:Komisioni është mbledhur dhe ka marrë informacionin teknik në lidhje me këto dy dokumenta të rëndësishëm, por Iliri mund të japë sqarime më tej për ju.

Z. Brahimi: Ky është një material I gjerë por unë kam disa pyetje:

Pse nuk ka një analizë financiare dhe afate kohore?Për 2025, kemi dy projekte dhe me kaç lekë. Si do të zvogëlohet risku? Si e keni menduar këtë?

Z. Ilir Cumaku:Që pas tërmetit të vitit 2019, nga Qeveria u vendos që për cdo njësi të vetëqeverisjes vendore të bëheshin studime të riskut zë më zë sipas nivelit të riskut.Në përrrenjtë malorë, ku për bashkinë tonë më të rrezikshëm mbeten përroi I Sopotit dhe përroi I Cullos.Ndër rreziqet e tjera janë konstatuar zjarret, rrëshkitjet sin ë rastin e kodrës së Cfakës të cilën jemi duke e trajtuar, rreziku nga dëbora që në bashkinë tonë kemi vetëm zonën e Golemit.Kjo është faza e parë e hartimit të këtyre dy dokumenta dhe më tej ne mund të hartojmë projekte për të thithur lekë nga donatorët dhe qeveria qëndrore.

Z. Golemi: Në këtë mbledhje jemi për paketën fiskale, por po ju informoj se te pjesa e buxhetit, pjesën e luanit e marrin investimet dhe emergjencat. Duke patur edhe këto dy material, të cilat janë detyrim ligjor kemi mundësi të thithim lekë nga donatorët nëpërmjet projekteve.

Hidhen në votë dhe miratohen me 21 vota pro P/Vendim “Për miratimin e Strategjisë së Zvogëlimit të Riskut nga fatkeqësitë në Bashkinë

Gjirokastër për periudhën 2024-2030”.

6.P/Vendim “Për miratimin e identifikimit të zonave me risk në territorin e Bashkisë Gjirokastrë për periudhën 2024-2030”

ZNJ. Isaraj ; Kalojmë te pika 7 e rendit të ditës” P/V “ Përmiratimin e amendimit të Marrëveshjes ndërmjet Bashkisë Gjirokastrë dhe Federatës Shqiptare të Futbollit”

Z. Golemi: Kjo marrëveshje ka për qëllim vazhdimin e investimeve në sport, ku 49% të investimit e bën bashkia Gjirokastrë dhe 51% e bën FSHF. Fondi Bashkisë është parashikuar në dy vite me 300 milion lekë të vjetra për secilin vit dhe përfshihet kompletimi me stola I stadiumit, ndërtimi I dy fushave të reja te Fusha e vjetër, për Akademinë Luftëtari trajnerët nga fondacioni dhe fëmijët nuk paguajnë. Kjo ka sjellë dyfishim të nr të fëmijëve.

Hidhet në votë dhe miratohet me 21 vota pro.

Kalohet te pika P/Vendim “Për miratimin e Paketës Fiskale 2025”.

ZNJ. Shehaj: Në Komisionin e Ekonomisë ka kaluar materiali dhe për vitin 2025 ka vetëm 2 ndryshime, ka një tarifë për parkimin e mikrobusëve nga linjat ndërqytetëse dhe tarifa e depozitimit të mbetjeve në vendgrumbullimin e tyre.

ZNJ. Orgesa Haska:Komisioni Juridik shqyrtoi të gjitha pikat e rendit të ditës dhe për Paketën Fiskale propozon të hiqet tarifa për familjarët.

Z. Hilaj:Një familje për njoftim punimesh paguan 2000 lek, ju shtojmë shenzimet sepse shkon me makinë te landfilli, paguan makinën, faturën. Ka dhe praktika më të mira për këto tarifa. Mos është pak herët për të paguar familjarët?

Z. Golemi; Nëse paguan për njoftim punimesh do kontrollohet, por ju jeni vetë dëshmitarë të mbushjes së koshave me inerte.

Z. Hilaj: Një firmë paguan bashkë me taksën e infrastrukturës edhe ndikimet në mjedis, Mendoj së është një diskutim I gjerë.

Z. Brahimi: Të paguajnë edhe familjarët se nuk është ndonjë tarifë e lartë.

Propozoj që të hiqet te tarifat pagesa e varrimit për fëmijët deri në një vjeç.Gjithashtu disa zona që s kanë ndriçim nuk duhet të të tarifohen me tarifën e ndriçimit .Gjithashtu kërkoj rritjen e disa tarifave për parkimin e qytetarëve dhe viznesit. Për parkimet të ketë tabela me orare përkatëse Në mbledhjen tjetër kërkojmë informacion me një listë emërore për parkimet që jep bashkia.

Gjithashtu , taksa e arsimit është e një tarifë e përkohshme dhe mendoj që duhet hequr .Kjo paketë anën humane e ka . Ka risi që duhen falënderuar dhe është bërë një punë e mirë.

Z. Golemi: jemi duke u future në vit zgjedhor dhe bazuar në ligj mund të bënim deri në 30% ndryshime, por nuk kemi ndryshim tarifash.

Patjetër që kemi hequr nga tarifat vendore shtresat në nevojë me 50 milionë minus në të ardhura, kemi mbledhur 94% të të ardhurave, kemi informalitet dhe ky është synimi ynë që të zvogëlojmë informalitetin dhe të zgjerojmë fashën e paguesve, që të jenë të gjithë të barabartë. Kemi rreth 120 hotele që tarifohen, por jemi të vetëdijshëm që ka më shumë. Por ju bëj me dije 2024 është një vit me stabilitet ekonomik. Edhe këtë vit na duhet tarifa e arsimit, sepse ju e dini punën që bëjmë nëpër shkolla ku po llojmë dhe jemi fitues në 10 projekte.Mund të bëjmë bdryshime në qershor 2025. 2025 do të jetë kantier ndërtimi. Po vazhdohet me shkollën e Lazaratit.

Z. Hilaj: Si do të vilet tarifa në vendgrumbullim? Krahاسimi i planit sa ishte parashikuar për 2024 dhe sa është realizuar?

Z. Peta:Në njësité administrative kemi problem me taksën e tokës, sepse rezidentët i paguajnë, kurse jorezidentët kur kthehen .Parashikojmë një rritje rreth 700.000 lekë dhe arrijmë në 2.5 miliard lekë.Këtë vit kemi të realizuara njësité administrative .

ZNJ. Isaraj: Hedhim në votë Paketën Fiskale për vitin 2025.

Miratohet me 20 vota pro P/Vendim “Për miratimin e Paketës Fiskale 2025”.

Propozohet që mbledhja e buxhetit 2025 të mbahet në datë 12.12.2024.

Mbyllet mbledhja nga znj. Isaraj .

Sekretar i Këshillit

Etleva YZO

KRYETAR I KËSHILLIT

Merita ISARAJ

